

Vendim nr. 62 datë 23.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 23.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (Gj) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GJERGJI SHELE**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 991, datë 04.05.2016 të Gjykatës së Apelit Administrativ dhe nr. 00-2022–3386, datë 01.11.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28, 29, 30 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gjergji Shele ka qenë punonjës i ish-Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm (*SHKB*), sot Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (*AMP*). Me urdhrin nr. 720, datë 21.09.2012 të drejtorit të përgjithshëm të SHKB-së është liruar nga detyra me motivacionin

“Dhënie e masës disiplinore si i paaftë për realizimin e detyrës së ngarkuar pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme të rezultateve në punë” (urdhri i lirit). Ky akt është bazuar në nenin 41, pika 4, të ligjit nr. 10002, datë 06.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme” (ligji nr. 10002/2008), i cili ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së tij.

2. Kërkuesi ka marrë dijeni për urdhrin e lirit në datën 24.09.2012 dhe në datën 09.10.2012 i është drejtuar me ankim administrativ ministrit të Brendshëm, duke kërkuar rikthimin e tij në detyrë. Në lidhje me këtë ankim, nuk ka marrë përgjigje.

3. Në datën 05.03.2013 ai ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar anulimin e urdhrit të lirit, kthimin në vendin e mëparshëm të punës, rikthimin e të gjitha të drejtave të cenuara, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtij urdhri, si dhe njohjen si vjetërsi shërbimi të kohës së ndërprerjes së karrierës.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 739, datë 30.05.2014, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Për pasojë, SHKB-ja ka paraqitur ankim ndaj vendimit, ndërsa kërkuesi ka paraqitur kundërankim.

5. Me vendimin nr. 991, datë 04.05.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se padia ishte paraqitur jashtë afatit 30-ditor, bazuar në nenet 50, shkronja “d” dhe 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), si dhe nenit 324 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), që ishte në fuqi në kohën e ngritjes së padisë. Gjykata ka llogaritur afatin duke filluar nga data 09.10.2012, kur kërkuesi i është drejtuar me ankim administrativ ministrit të Brendshëm.

6. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (Gjykata e Lartë), me vendimin nr. 00-2022–3386, datë 01.11.2022, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

7. Në datën 16.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

8. Në vitin 2014 është miratuar ligji nr. 70/2014 “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”, që ka hyrë në fuqi në datën 23.10.2014 dhe ka shfuqizuar ligjin nr. 10002/2008, i cili është ndryshuar sërish me ligjin nr. 128/2021 “Për

Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”. Si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve, emërtimi i SHKB-së është ndryshuar në Agjenci të Mbikëqyrjes Policore (AMP).

II

Pretendimet e kërkesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 9.1. *Parimi i sigurisë juridike*, për shkak të moszbatimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të disa vendimmarrjeve të Gjykatës Kushtetuese.
- 9.2. *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ ka shkelje të rënda procedurale për kalimin procedural dhe cilësimin e palëve ndërgjyqëse. Ai është i marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi çështja objekt gjykimi është mosmarrëveshje në fushën e marrëdhënieve të punës, pavarësisht se akti administrativ “Urdhër lirimi nga detyra”, është nxjerrë nga organ i administratës publike. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka gabime të dukshme materiale dhe pasaktësi në lidhje me kërkimet në rekurs. Vendimet e të dyja gjykatave kanë mungesë arsytimi.
- 9.3. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak të zvarritjeve të qëllimshme të gjykimit, edhe pse kërkesi në mënyrë të përsëritur ka kërkuar përsheptimin e tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimitetit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

12. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji çmon se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm për vendimet për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individ duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Ai parashtron se çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në datën 05.03.2013 dhe ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë në datën 01.11.2022, duke pretenduar se gjykimi është zvarritur pa shkak dhe në mënyrë të qëllimshme.

15. Kolegji thekson se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 05.11.2017, është përcaktuar se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), shpërblim i drejtë (*neni 399/3*) dhe cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshi rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive për t’i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm.

16. Kolegji vëren se rekursi i kërkuësit është regjistruar në datën 30.05.2016, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të KPC-së, që do të thotë se ai ka pasur të gjitha mundësitë

që t'i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së shqyrtimit të rekursit të tij. Ndërkohë, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues, edhe pse kërkuesi ka pretenduar se ka kërkuar në mënyrë të përsëritur përshpejtimin e gjyqimit, nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar se e ka përdorur paraprakisht këtë mjet juridik që ka pasur në dispozicion sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së.

17. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për rrjedhojë pretendimi për cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera për sigurinë juridike dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi nuk ka më mjete juridike në dispozicion, për pasojë e ka përmbushur këtë kriter të legjitimitit.

18. Në vijim, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Konkretisht, ajo është paraqitur në Gjykatë në datën 16.02.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 01.11.2022.

19. Në drejtim të legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

20. Kolegji vëren se pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike kërkuesi e ka mbështetur në argumente që lidhen me moszbatimin nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të vendimeve nr. 15, datë 10.03.2016 dhe nr. 27, datë 26.05.2010 të kësaj Gjykate, por pa parashtruar ndonjë rrethanë konkrete të çështjes së tij ose të ndonjë vendimi të Gjykatës që ndikon në çështjen e tij. Me fjalë të tjera, në ankimin kushtetues ai nuk ka argumentuar konkretisht përse gjykatat nuk kanë respektuar parimin e sigurisë juridike, sipas kuptimit që i ka dhënë jurisprudenca kushtetuese, që ai ka cituar në ankimin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuetit nuk rezulton të jetë ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Ndërsa, për sa i takon pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, që është aspekt i procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, ai *prima facie* hyn në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

22. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka gabime të dukshme materiale, nuk përputhet me kërkimet e tij në rekurs, pasi i ka transformuar, duke pasqyruar thënie të rreme, arsye për të cilat ai ka bërë kërkesë për ndreqje të tyre. Po kështu, as Gjykata e Apelit Administrativ, as Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar nëse palët në gjykim janë të njëjtat me ato të gjykimit të përfunduar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, nëse mosmarrëveshja lidhet me marrëdhënien e punës dhe cili është afati për ngritjen e padisë referuar përcaktimeve ligjore të zbatueshme. Vendimi i Gjykatës së Apelit Administrativ është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi ajo nuk mund të shprehej për pushimin e çështjes, pas pranimi të pjesshëm të kërkesëpadisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë. Zgjidhja e kontratës së punës në mënyrë të paligjshme dëmshpërblehet nga neni 37, pika 5, i ligjit nr. 49/2012 dhe Kodi i Punës, ky i fundit parashikon afatin 6 muaj deri në 3 vjet për ngritjen e padisë. Po kështu, kjo gjykatë nuk ka zbatuar nenet 199, paragrafi i dytë dhe 459, të KPC-së, pasi nuk ka realizuar kalimin procedural dhe zëvendësimin e SHKB-së me emërtimin e ri, duke e kaluar këtë gjë në heshtje.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e mospranimi të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimi të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Duke verifikuar respektimin e këtij standardi në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, përmban të dhënat e palëve,

rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në rekurs, referencat ligjore të përdorura nga kërkuesi për të vërtetuar pretendimet e tij, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo gjykatë ka çmuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se atyre i është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga Gjykata e Apelit Administrativ, e cila ka analizuar dispozitat ligjore të zbatueshme. Ai nuk rezulton të jetë kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm apo me kundërthënie ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

25. Po kështu, Kolegji vëren se ndonëse kërkuesi ka parashtruar se ka paraqitur kërkesë për ndreqjen e vendimit, ai nuk i ka bashkëngjitur ankimit kushtetues ndonjë dokument për të provuar këtë fakt, si dhe nuk ka treguar se cilat janë këto gabime dhe në ç'mënyrë ato kanë ndikuar në vendimin gjyqësor të kundërshtuar. Ndërsa, për sa u përket argumenteve të kërkuesit se vendimet janë marrë në zbatim të gabuar të legjislacionit procedural dhe material që rregullon marrëdhëniet e punës, Kolegji sjell në vëmendje se në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Lidhur me argumentin e kërkuesit se gjykatat kanë kryer shkelje të rënda procedurale, pasi Gjykata e Apelit Administrativ nuk ka realizuar kalimin procedural dhe zëvendësimin e të paditurit me emërtimin e ri, Kolegji evidenton se ndryshimi i emërimit që ka pësuar SHKB-ja nuk mund të klasifikohet si rrethanë për kalimin procedural, në kushtet kur institucioni ka vijuar të ushtrojë veprimtarinë e tij. Me fjalë të tjera, ndryshimi i emërimit nuk sjell si pasojë mbarimin e personalitetit juridik të këtij institucioni dhe se në rastin konkret ankimi është ushtruar nga institucioni publik në vijimësi të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

27. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.